



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1019/3 prot.

Tiranë më 15.9.2017

V E N D I M

Nr. 87, datë 15.9.2017

PËR

LEJIMIN E TRANSFERIMIT NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 9 dhe pikës 1 të nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës administruar me nr. 1019 prot, datë 11.08.2017, për pajisje me autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale nga transferuesi **ProCredit Bank sh.a** në marrësin **Qendra e Procesimit QUIPU sh.p.k** në Republikën e Kosovës;

K O N S T A T O V A:

Subjekti kontrollues, ProCredit Bank sh.a ka kërkuar nga Autoriteti i Komisionerit pajisjen me autorizim për transferimin e të dhënave personale në marrësin Qendra e Procesimit QUIPU sh.p.k e vendosur në Kosovë.

Sipas deklarimeve të subjektit në *Formularin e Aplikimit për Aprovimin e Transferimit të të Dhënave Personale në një Shtet që nuk ka Nivel të Mjaftueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave*, administruar pranë KDIMDP, transferimi që kërkohet të autorizohet nga Autoriteti i Komisionerit përmban elementët e mëposhtëm:

Kategoria e të dhënave objekt transferimi:

1. Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
2. Numri personal i identifikimit;
3. Numri i sigurimit shoqëror;
4. Situata ekonomike e financiare;
5. Të dhëna biometrike;
6. Adresa (karakteristikat e banesës);
7. Foto.

Shteti ku do të realizohet transferimi: Kosovë.

Kategoria e subjekteve të cilëve u transferohen të dhëna personale janë: Klientë.

Frekuenca e Transferimit është: Vazhdimisht, përditë.

Qëllimi i transferimit. Citojmë: “Të dhënat e sipër përmendura do të transferohen në Kosovë si rezultat i marrëveshjes dypalëshe mes bankës ProCredit Shqipëri dhe QUIPU GBMH për transferimin e shërbimeve të Qendrës së Kontaktit të PCBA në Qendrën e Procesimit QUIPU në Kosovë”.

Ndërkohë në Rubrikën 7, të Formularit të Aplikimit “*Rrethanat lidhur me përpunimin*” subjekti transferues ka deklaruar, citojmë: Proceset që do kryhen nga Qendra e Procesimit QUIPU në Kosovë do jenë si më poshtë:

1. Bllokimi i kartave të klientëve në rastet:

- Klienti lajmëron për një kartë të vjedhur dhe/ose
- Karta e klientit rezulton në Fraud Analyzer

Kartat bllokohen në Tranzware FIMI online version 4.1

2. Monitorimi i transaksioneve të kartave në TWFA (Tranzware Fraud analyzer 64)

3. Monitorimi i procesit të fund-dites (EoD)

4. Raportimi dhe regjistrimi në baza ditore i telefonatave/kërkesave”.

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave, citojmë: “Gjatë kohëzgjatjes së shërbimit të mësipërm nuk do ketë në asnjë moment ruajtje të dhënash të klientëve apo dokumenti jashtë sistemeve bankare të Procredit Bank sh.a Shqipëri. Të gjitha përditësimet do bëhen në këto sisteme, të mundësuar nga lidhja “VPN”.

Në bazë të Vendimit të Komisionerit Nr. 8, datë 31.10.2016 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, Kosova nuk është në listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Në këto kushte në zbatim të nenit 9 pika 1, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, subjekti kontrollues ProCredit Shqipëri është në kushtet ku ky transferim duhet kryer pas marrjes së Autorizimit nga Komisioneri mbi ligjshmërinë e realizimit të tij.

Në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur nga kontrolluesi dhe studimi i përmbajtjes së tyre rezulton që ky transferim të dhënash personale të jetë në përputhje me respektimin e mbrojtjes së të dhënave personale sipas akteve ndërkombëtare dhe vendase, dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 41, datë 13.06.2014 për “Lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Sa më sipër, kërkesa për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale nga kontrolluesi ProCredit Bank Shqipëri plotëson kërkesat ligjore për t’u pajisur me Autorizim për transferimin e të dhënave personale të kërkuara;

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, shkronja b, c nenit 9, pika 2 dhe nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;

V E N D O S A :

1. Lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale nga kontrolluesi ProCredit sh.a Shqipëri, duke përcaktuar si më poshtë:
Kontrolluesi ProCredit Bank sh.a Shqipëri lejohet të transferojë sa herë të jetë e nevojshme, tek marrësi i të dhënave Qendra e Procesimit QUIPU sh.p.k e vendosur në Kosovë kategorinë e të dhënave personale të klientëve, si më poshtë:
 - Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
 - Numri personal i identifikimit;
 - Numri i sigurimit shoqëror;
 - Situata ekonomike e financiare;
 - Të dhëna biometrike;
 - Adresa (karakteristikat e banesës);
 - Foto.
2. Të dhënat e cituara më sipër do të transferohen vetëm për qëllimin e deklaruar nga transferuesi në Formularin e Aplikimit për Autorizim mbi Transferimin e të Dhënave Personale, të paraqitur pranë Komisionerit dhe që ka të bëjë me transferimin e shërbimeve: 1- Bllokimin e kartave të klientëve në rastet kur klienti lajmëron për një kartë të vjedhur dhe/ose karta e klientit rezulton në Fraud Analizer. 2-Monitorim i transaksioneve të kartave në TWFA (Tranzware Fraud analyzer 64). 3-Monitorimi i procesit të fund-ditës (EoD). 4-Raportimi dhe regjistrimi në baza ditore i telefonatave/kërkesave.
3. Të dhënat personale të lejuara për t'u transferuar (parashikuar në pikën 1), nuk do të ruhen për asnjë moment jashtë sistemeve bankare të Procredit Bank sh.a Shqipëri. Të gjitha përditësimet do bëhen në këto sisteme.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u dha sot më datë 15/9 2017

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

